

## Procesverbal

Nga

FAZA E DYTË e diskutimeve publike për Projekt-Kushtetutën e Kosovës

**Koha dhe vendi: Vushtrri, 23 shkurt 2008**

**Panelistët: Mahir Jagcilar, Ramadan Kelmendi, Bajram Latifi – anëtarë të Komisionit Kushtetues**

**Fjala hyrëse e panelistëve:**

### **Mahir Jagcilar**

Kushtetuta është akti më i lartë juridik i një shteti, kështu edhe ligjet duhet të jenë në përputhje me kushtetutën. Kushtetuta është burim për funksionimin e shtetit. Deri sot, në procesin e hartimit të draftit kushtetues, anëtarët e komunitetit serb nuk kanë marrë pjesë mirëpo në disa momente kanë qenë të involvuar ose janë konsultuar. Draft-kushtetuta e Republikës së Kosovës do të ketë 14 kapituj dhe preambulën. Deri tash kemi punuar në një klimë të mirë me respekt dhe përkushtim të të gjithë anëtarëve dhe kushtetuta e propozuar do të jetë kushtetuta e të gjithë qytetarëve të Kosovës pa dallim feje apo etnie. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në përputhje me propozimin e z. Ahtisarit. Po ashtu kam qenë edhe kryesues i nëngrupit për komunitete dhe të drejtat e komuniteteve, ndërsa Projekt-kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë të drejtat siç përdorimi i gjuhës, e drejta për arsimimin në gjuhë amtare, e drejta për zhvillim kulturor, e drejta për media në gjuhën amtare, e drejta e themelimit të shoqatave dhe asociacioneve, përfaqësimi në Parlament, përfaqësimi në Qeveri, përfaqësimi në Pushtetin Lokal e gjithashtu edhe disa të drejta tjera.

Unë kam cekur se shumë e rëndësishme do të jetë krijimi i Gjykatës kushtetuese, krijimi i forcave të sigurisë, policisë dhe agjencisë së inteligjencës. Do të jenë edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe institucionet e pavarura. Sigurisht që Draft-kushtetuta nuk është aq e përkryer, kështu që ftoj të gjithë qytetarët të jenë pjesë e procesit sidomos edhe anëtarët e komunitetit turk dhe të komuniteteve tjera pakicë të marrin pjesë aktive në këtë proces ashtu që të kemi kushtetutë sa më të mirë dhe të pranueshme për të gjithë.

### **Ramadan Kelmendi**

Kjo kushtetutë është publikuar në mjetet e informimit, të shkruara dhe elektronike, dhe jam i bindur se keni pasur mundësi ta lexoni, ta elaboroni në mënyrë konkrete t'i shtroni pyetjet gjegjësisht të kërkonte sqarime për ndonjë çështje, dispozitë apo edhe kapitull i cili nuk u ka lënë përshtypje në zbërthimit të konceptit tuaj lidhur me kushtetutën. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është kushtetutë moderne, bashkëkohore e demokratike bazuar në themelet e shtetësisë së Kosovës dhe vullnetit të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Kjo kushtetutë mbështetet në shumë kushtetuta demokratike por çdo herë duke pasur për qëllim ruajtjen e planeve të shoqërisë kosovare, interesave të minoriteteve, ruajtjes dhe avancimit të këtyre interesave. Me kushtetutën e re vihen themelet juridike kushtetuese të shtetit të Kosovës të rikonfirmuar edhe me Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është akt juridik i shtetit të Kosovës me fuqinë më të madhe juridike brenda kufijve të vet. Është ligj bazë i shtetit të Kosovës me të cilin rregullohen çështjet kryesore. Është akti më suprem politik i cili do të miratohet me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet që do të vijnë me këto debate të fazës së dytë - nga organi më i lartë ligjdhënës i Republikës së Kosovës - Kuvendi i Republikës së Kosovës.

### **Bajram Latifi**

Temë e takimit të sotëm është informimi i qytetarëve për dispozitat e parapara në këtë Draft-kushtetutë. Unë do të them vetëm një fjali dhe do t'jua lë kohën e çmuar juve që të shtroni pyetjet

tuaja. Qytetarët e Kosovës duhet të gjithë të jenë krenarë për ato dispozita të cilat i përfshinë kjo kushtetutë. Kjo nuk vjen nga anëtarët e Komisioni Kushtetues por nga ekspertët ndërkombëtarë dhe ekspertëve që kanë ndihmuar komisionin kushtetues, si dhe përfaqësuesve të cilët kanë pasur për detyrë të bëjnë mbikëqyrjen apo kontrollin e kësaj projektkushtetute. Ju lutem të parashtroni pyetjet.

## **Pyetjet / Komentet e Pjesëmarrësve:**

### **Kapitujt e Kushtetutës**

#### **Preambula**

#### **Qytetari**

Me gjithë punën e madhe të Komisionit për të hartuar këtë kushtetutë kam disa vërejte lidhur me formulimin e pikave. Mendoj se në Preambulë duhet të ishte inkorporuar një fjali e cila thotë se e kjo kushtetutë është e bazuar në Deklaratën për Pavarësi.

#### **Ramadan Kelmendi**

Roli dhe rëndësia e Preambulës historikisht e përcjell çdo kushtetutë në botë . Rrethanat në të cilat ne jemi pranuar si shtet ndërkombëtarisht kanë kushtëzuar që ardhmëria e Kosovës të përcaktohet në këtë fazë me këtë kushtetutë si shtet i qytetarëve të barabartë. Elementi i dytë është të krijohet një mirëqenie dhe perspektivë sociale për të gjithë qytetarët. Ajo varet shumë nga ne duke krijuar stabilitet ekonomik, politik, kulturor, religjioz, etj.

#### **Dispozitat themelore**

#### **Qytetari**

Mendoj se në nenin 16 krahas formulimit “akti më i lartë juridik” të jetë shtuar edhe termi “dhe politik” i një shteti.

#### **Mahir Jagcilar**

Të gjitha këto pyetje do t’i marrim dhe do t’i analizojmë edhe në kuadër të komisionit kushtetues.

#### **Qytetari**

Çfarë valute do të ketë shteti i Kosovës dhe çfarë simboli do të ketë ajo valutë?

#### **Ramadan Kelmendi**

Me këtë kushtetutë është përcaktuar që Kosova do të ketë një valutë. Fatmirësisht edhe para se të ishim pranuar ndërkombëtarisht për valutë kishim euron. Mendoj se me këtë valutë nuk qëndrojmë keq dhe jemi në avantazh me shumë shtete të rajonit. Euro është një valutë shumë e qëndrueshme në tregun e ekonomisë së lirë por edhe në shkëmbimin valutator ndërkombëtar.

#### **Qytetari**

A kanë të drejtë në shtetësi apo jo familjarët tanë që kanë shkuar para vitit 1998 jashtë Kosovës?

#### **Mahir Jagcilar**

Sa i përket shtetësisë, kemi aprovuar ligjin për shtetësi para disa ditëve në Kuvend dhe me ligj është përcaktuar më hollësisht se çdo kosovar i cili ka lindur në Kosovë ka të drejtë në shtetësi por edhe të gjithë ata të cilët kanë jetuar deri në atë periudhë. Me Kushtetutë ekziston edhe mundësia për dy shtetësi por varet nga shteti tjetër apo marrëveshjet bilaterale.

#### **Qytetari**

Neni 5 ku flitet për përdorimin e gjuhës a do ta kemi në të ardhmen në përdorim zyrtar gjuhën turke?

**Mahir Jagcilar**

Edhe me kushtetutën e vitit '74 gjuha turke ka qenë një prej gjuhëve me përdorim të barabartë, e edhe me kushtetutën e Kaçanikut ka qenë e barabartë. Tash është pak më ndryshe, ndoshta në të ardhmen do t'i saktësojmë këto çështje sepse është në të mirën e të gjithëve. Nëse gjuha serbe është gjuhë zyrtare ndoshta në të ardhmen ku jetojnë komunitetet do të ishte më mirë brenda kufijve të komunës gjuhë zyrtare ose në përdorim zyrtar. Besoj se edhe legjislacioni dhe Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë do të aprovojë dhe gjuha turke të jetë në përdorim zyrtar. Kjo kushtetutë jep mundësi të mbrohet identiteti i të gjitha komuniteteve.

**Qytetari**

Te neni 19 pika 2 thuhet se e drejta zakonore ndërkombëtare dhe të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara gëzojnë epërsinë mbi ligjet e Republikës së Kosovës të cilat nuk janë në përputhje me to. A e praktikojnë edhe shtetet tjera bashkëkohore të njëjtën gjë?

**Mahir Jagcilar**

Ekziston një përgjigje në nenin 18 pika 2 që thotë se Marrëveshjet ndërkombëtare përveç atyre të shënuara në paragrafin 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

**Qytetari**

Në kushtetutë qëndron se banor i Kosovës mund të jetë ai që ka pas banim të përhershëm para një janarit 1998, e pse jo 1989?

**Ramadan Kelmendi**

Ju e dini se qëndrimi i grupit të kontaktit ka qenë që Kosova nuk mund të kthehet në gjendjen paraprake dhe pikërisht kjo ka qenë baza politike e cila ka vendosur një përcaktim dhe formulim të tillë. Dhe po e them me përgjegjësi se është fat i mirë që është respektuar ai kriter.

**Të drejtat dhe liritë themelore****Qytetari**

A është e rregulluar me referendum e drejta për çështje të caktuara dhe nëse jo për çfarë arsye?

**Bajram Latifi**

Referendumi ose deklarimi personal i qytetarëve është formë amë e drejtpërdrejtë e nxjerrjes së vendimeve nga ana e qytetarëve. Në këtë Draft-kushtetutë të gjitha kompetencat rreth referendumit janë dhënë në kompetencë të Kuvendit të Kosovës. Pra për të gjitha çështjet për të cilat do të ketë nevojë që qytetarët të shprehën me referendum do të vendosë Parlamenti i Kosovës.

**Qytetari**

Kam vërejtje në nenin 37 për të drejtën e martesës dhe familjes dhe nuk pajtohem se çdokush mund të lidhë martesë si p.sh. homoseksualët. Mendoj se për të drejtën prindërore flitet pak dhe për mbrojtjen e fëmijëve flitet pak. Kam vërejtje edhe në nenin 51 pasi që flitet tepër pak për mbrojtjen shëndetësore dhe nenin 52 ku flitet për mjedisin. Do të duhej pak më shumë fjalë për regjimin e ujërave që është çështje serioze dhe interes kombëtar.

**Ramadan Kelmendi**

Ajo që dikush më ka bindë gjatë gjithë këtyre debateve është përcaktimi kushtetues i pasurisë kombëtare ku aludohet në ujërat dhe pasuritë nëntokësore dhe sipërfaqësore. Është një pyetje të cilën e kam shënuar dhe do ta paraqes para komisionit për shqyrtim.

### **Mahir Jagcilar**

Ekziston një nen sa për përdorimin e pasurisë dhe burimeve natyrore ku përmenden edhe hapësira ajrore. Sa janë të mjaftueshme këto, ne sigurisht që do t'i analizojmë.

### **Qytetari**

Në nenin 47, pika e tretë - të jetë për arsimimin e obligueshëm qeveria të angazhohet që të sigurojë tekste të nevojshme falas.

### **Mahir Jagcilar**

Sa i përket çështjes se a do të jetë Qeveria e obliguar për të siguruar tekste, do ta shqyrtojmë këtë çështje brenga Komisionit Kushtetues.

### **Qytetare**

Neni 35 përcakton të drejtën që shtetasit e Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin e tyre. Disa herë më është dashur të intervenoj për sigurinë time tek forcat e NATO-s kur kam shkuar në punë në pjesën veriore të Mitrovicës. Si do të rregullohet kjo çështje në të ardhmen?

### **Ramadan Kelmendi**

Obligim kushtetues është të garantohet liria e lëvizjes dhe e qytetarit pa dallim, dhe synimi i kësaj kushtetute qëndron në atë. Me guxim tonë t'i kthehemi shtëpive dhe banesave tona pa frikë. Në bashkëpunim dhe me kontributin e bashkësisë ndërkombëtare për t'i përmbushë obligimet që kanë marrë nga dokumenti i Ahtisarit, nga kjo kushtetutë e shtetit të Kosovës, me angazhimin e policisë së shtetit të Kosovës. Jemi në fazën e parë ku edhe bashkësia ndërkombëtare çmon shumë kujdesin e shqiptarëve dhe të të gjitha komuniteteve tjera, në përjashtim të serbëve të cilët nuk pajtohen me shtetin e Kosovës. Së shpejti kjo do të amortizohet dhe besoj se do të shkosh në punë lirisht. Unë sonte do të shkoj atje se jam qytetar i asaj pjese.

### **Qytetari**

Si rregullohet nacionaliteti i fëmijëve nga bashkësitë martesore të komuniteteve dhe a kanë të drejtë të lidhin martesë të gjithë?

### **Bajram Latifi**

Është e drejtë e personale e tyre të deklarohen çka janë.

### **Qytetari**

Në nenin 45 thuhet se çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeçare, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet përveç nëse kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Mendoj se ka pengesa formale juridike pasi që ai mund të zgjedh ditën që mbush moshën 18 vjeçare por nuk mund të hyj në listën kandiduese sepse ai atë ditë mbush 18 vjet.

### **Ramadan Kelmendi**

Sistemi zgjedhor tek ne ka lënë pasoja dhe një pjesë e madhe jemi pasojë e pjesëmarrjes së sistemit të pjesëmarrjes së kandidimit në zgjedhje. E drejtë fundamentale e qytetarit është e drejta për të qenë i zgjedhur dhe për të zgjedhë. Dhe dihet kush nuk ka të drejtë për tu zgjedhë. Shërbimi policor, gjyqtarët, mos t'i numëroj. Ne duhet të vetëdijesohemi në komentimin e ligjeve dhe zbatimit të tyre realisht. Kushtetuta duhet të shpjegohet në mënyrë burimore dhe ligjet duhet interpretuar objektivisht.

## **Kuvendi i Republikës së Kosovës**

### **Qytetari**

Shumë qytetarë të Kosovës që janë kandiduar në zgjedhje kanë pasur për detyrë të tregojnë pasurinë e tyre por jo edhe prejardhjen e pasurisë së tyre. Mendoj se do të ishin të detyruar ta bënin këtë por edhe qytetarët një herë në 4 vjet duhet ta deklarojnë prejardhjen e pasurisë së tyre.

### **Ramadan Kelmendi**

Me kushtetutë nuk ka mundësi të përcaktohet prejardhja e pasurisë së asnjë titullari apo të asnjë deputeti. Ndërsa me ligjin mbi imunitetin përgjegjësitë dhe obligimet e deputetit përcaktohet se çdo deputet dhe ushtrues i funksioneve është i obliguar ta paraqesë pasurinë e vet dhe të këtë pasuri. Ai duhet ta paraqesë në mënyrë sa më të ndërgjegjshme.

### **Qytetari**

Po prejardhjen?

### **Ramadan Kelmendi**

Është kërkuar me plotësimin e këtij ligji i cili ende nuk ka kaluar e që është dispozitë plotësuese që secili deputet ta tregojë edhe prejardhjen e pasurisë dhe të mos i lihet mundësia e përpjesëtimit të pasurisë me gruan, djalin e mikun, por pasuria decidive të jetë në emër të atij titullari / funksionari apo deputeti.

## **Presidenti i Republikës së Kosovës**

### **Qytetari**

Kam propozim që presidenti të zgjidhet nga populli e jo nga Kuvendi.

### **Mahir Jagcilar**

Për këto çështje është folur edhe në komision dhe në rrafshin politik dhe është menduar që zgjedhja e presidentit të bëhet në Kuvend, por brenda Komisionit përsëri do të diskutojmë për këtë.

### **Ramadan Kelmendi**

Kosova është përcaktuar si Republikë parlamentare e jo presidenciale. Duke pasur shumë kompetenca kryetari shumë shpesh “ del jashtë dore”. Prandaj është menduar që t’i përgjigjet Kuvendit si organit më të lartë ligjdhënës.

## **Dispozitat përfundimtare**

### **Qytetari**

Kam vërejtje në nenin 143 ku thuhet se prania ndërkombëtare ushtarake ka të drejtë të rivendosë kontrollin ushtarak mbi hapësirën ajrore të republikës së Kosovës. Mendoj se njëherë e ka vendosë dhe se duhet pëlqimi i Kuvendit të Kosovës.

### **Mahir Jagcilar**

Në tekstin e Deklaratës së Pavarësisë qëndron kjo dhe jemi deklaruar nëpërmjet kësaj deklaratë.